



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJËS**

Nr. 2066 Prot.

Tiranë, më 10.11.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1738, datë 08.01.2015.

**SHOQËRISË “AS MINERAL LTD” SH.P.K**  
Njesia Bashkiake nr.5, Rr. “Ismail Qemali”, Pallati 34/1, Kati I-re, Tiranë

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “AS MINERAL LTD” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1738, datë 08.01.2015, për mineralin Traktolite, në objektin “Manëz”, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.890, datë 22.02.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.2066, Prot, datë 23.02.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1738, datë 08.01.2015, për mineralin Traktolite, në objektin “Manëz”, Qarku Korçë, sepse nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitet 2019 dhe 2020.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare shfrytëzimit Nr.1738, datë 08.01.2015, për mineralin Traktolite, në objektin “Manëz”, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1738, datë 08.01.2015, për mineralin Traktolite, në objektin “Manëz”, Qarku Korçë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**

**ILIR BEJTJA**

